

IKAF F7 Raportimi Financiar

Syllabus dhe Udhëzues Studimi

*Kualifikimi Kontabilist i Certifikuar
(Bazuar në Certifikimet ACCA)*

Ky planprogram dhe udhëzuesi i studimit është i dizajnuar për të ndihmuar në mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhe ka për qëllim të ofrojë informata të hollësishme në lidhje me kualifikimin, modulën dhe udhëzuesin e studimit.

Struktura e Kualifikimit

Shpjegon përmbajtjen e kualifikimit të nivelit Kontabilist i Certifikuar në të cilën bënë pjesë edhe moduli Raportimi Financiar. Ndërlidhja e këtij moduli me nivelet dhe modulet tjera të kualifikimit. Modulet e përfshira në nivelin e caktuar si dhe kriteret për antarësim; si dhe karakteristikat e ligjeratave të cilat mbahen gjatë periudhës së certifikimit. Modulet dhe Kualifikimi janë paraqitur edhe me anë të diagramit.

Moduli

Shpjegon shkurtimisht arsyetimin e rëndësisë së modulit, objektivat e përgjithshme dhe të detajuara të modulit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që do të zhvillohen gjatë studimit të modulit në fjalë. Ndërlidhja e modulit me modulet tjera të caktuara paraqitet me anë të një diagrami, që paraqesin lidhjet ndërmjet tyre; me qëllim që të jetë sa më e qartë për lexuesin. Poashtu përshkruhen dhe temat që i përkasin modulit; se si është planifikuar moduli me tema dhe nëntema. Gjithashtu, shpjegohen edhe forma e ekzaminimit dhe vlerësimit, në detaje se çfarë do të shqyrtojë provimi dhe pse. Në fund krejt është bashkangjitur shtojca e përmbajtjes së modulit.

Struktura e Syllabusit

Shpjegon përmbajtjen e syllabusit të modulit Menaxhimi i Performances i cili është pjesë e nivelit Raportimi Financiar. Ky modul përmban arsyetimin, qëllimin dhe aftësitë kryesore që pritet të fitohen gjatë kohës së studimit. Veç kësaj syllabusi përfshinë edhe temat e modulit në fjalë, strukturën e ekzaminimit pas përfundimit me sukses të modulit si dhe të lexuarit dhe planifikimin e kohës.

Udhëzuesi i Studimit

Ky është seksioni kryesor i të dhënave që nxënësit dhe mësimdhënësit duhet ta përdorin si bazë të studimeve, mësimve dhe materialeve të tyre përkatësisht. Provimet do të bazohen në detajet e udhëzuesit të studimit i cili identifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse se çfarë mund të vlerësohet në çdo seancë provuese. Udhëzuesi i studimit është i ndarë në seksione të bazuara në aftësitë kryesore të identifikuara në programin mësimor. Këto seksione ndahen në fusha të lëndëve që lidhen me nën-aftësitë e përfshira në planprogramin e detajuar. Fushat e lëndëve ndahen në nëntituj që përshkruajnë rezultatet e detajuara që mund të vlerësohen në provime.


STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

*Kualifikimi Kontabilist i Certifikuar
(Bazuar në Planprogramet ACCA)*

Planprogrami për kualifikim për Kontabilist të Çertifikuar siguron një theks të veçantë në aftësitë e raportimit financiar të cilat janë zhvilluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kontabilistët e Çertifikuar do të mësojnë parimet dhe sistemet e kontrollit të brendshëm për ndërmarrjet, metodat e auditimit dhe standardet si dhe një grup të gjerë të planifikimit të biznesit, mbështetjen e vendimeve dhe aftësitë e menaxhimit të performancës.

Për t'u trajnuar për Kontabilist të Çertifikuar ju duhet së pari të përfundoni kualifikimin për Teknik të Kontabilitetit. Anëtarësia për Kontabilist të Çertifikuar është e hapur për profesionistët të cilët punojnë në kontabilitet e të cilët kanë përfunduar kualifikimin e IKAF për Teknik të Kontabilitetit.


Kandidatët në Kualifikimin për Kontabilist të Certifikuar duhet të demonstrojnë njohuri të veçanta edhe në modulën "Raportimi Financiar".



Diagrami.1.: Nderlidhjet e moduleve dhe certifikimeve deri tek titulli Kontabilist i Certifikuar

Modulet

Kualifikimi Kontabilist i Certifikuar përmbanë gjithsej pesë module të cilat duhet të studiohen dhe të përfundojnë me sukses; me qëllim të fitimit të titullit.



Diagrami.2.: Modulet e Kualifikimit Kontabilist i Certifikuar

Kriteret e kualifikimit dhe anetaresimit: Kontabilist të Certifikuar

- Diplomë Universitare;
- Përfundimin e nivelit për Teknik të Kontabilitetit;
- Dëshmi për së paku tre (3) vite përvojë pune të verifikuar në kontabilitet - që mund të përfitohet edhe gjatë apo pas trajnimit.
- Të kenë vijuar dhe kaluar pesë (5) provimet e certifikimit për këtë qëllim (Provimi quhet i dhene nese arrihet 50% e pikeve ne test).
- Personi që është i certifikuar në këtë kualifikim nga IKAF dhe vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë IKAF-it, ka të drejtë të përdor titullin “Kontabilist të Çertifikuar” duke plotësuar gjitha kriteret e mesiperme.
- Antaret e rregullt ne IKAF për ta përdor titullin “Kontabilist të Çertifikuar” e kane obligative ndjeken e edukimit te vazhdueshem professional (EVP/CPD) te percaktuara edhe ne rregullore te IKAF-it.

Karakteristikat e ligjërates trajnuese:

- Rishikimi i përgjithshëm i moduleve; dhe gjatë ligjërates, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shmebuj të provimeve.
- Ligjëruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushen e caktuar të ligjerimit.
- Planprogrami trjanues është i bazuar në planëprogramet ACCA.
- Në përfundim të kësaj ligjërates, studentet do të jenë te gatshëm ti nënshtrohen provimit në qendren e Institutit KAF.

STRUKTURA E SYLLABUSIT

Arsyetimi

Shpjegon se si është strukturuar programi dhe si janë të ndërlidhura aftësitë kryesore. Arsyetimi gjithashtu shpjegon në detaje se çfarë do të përmbajë ekzaminimi dhe pse.

Diagrami i relacioneve mes moduleve

Ky diagram tregon lidhjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta midis këtij moduli dhe moduleve të tjera që i paraprijnë ose pasojnë. Ai tregon se ku ju pritët të keni njohuri themelore dhe ku do të ishte e dobishme të rishikoni të mësuarit e mëparshëm përpara se të filloni studimin.

Qëllimi

Kjo shpjegon shkurtimisht objektivin e përgjithshëm të planprogramit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që duhet të zhvillohen brenda studimit të modudit.

Aftësitë kryesore

Qëllimi i planit mësimor është i ndarë në disa funksione kryesore që ndajnë programin mësimor dhe udhëzuesin studimor në seksione diskrete.

Temat

Temat e caktuara që i përmbanë moduli dhe që do të trajtohen gjatë studimit dhe ligjerimit.

Struktura e Ekzaminimit

Ky seksion shpjegon shkurtimisht strukturën e ekzaminimit dhe si bëhet vlerësimi.


Shtojcë Syllabusi i Detajuar

Kjo tregon ndarjen temave dhe nëntemave kryesore të planprogramit në fushat e lëndëve. Ky është pilotprojekt për manualin e detajuar të studimit.

MODULI

Arsyetimi

Planprogrami i modulit F5 Raportimi Financiar, parasheh njohuri paraprake të modulit F3, Kontabilitetit Financiar dhe i shtjellon dhe i përdor tutje për tu kuptuar më thellë.



Diagrami.1.: Ndërlidhja e moduleve

Planprogrami fillon me kornizen konceptuale të kontabilitetit duke i'u referuar karakteristikave cilesore të informacionit të vlefshëm dhe bazave thelbësore të kontabilitetit të paraqitura në planprogramin e modulit F3 Kontabiliteti financiar në modulën e njohurive. Mëpas vazhdon me një vështrim të detajuar të kornizës konceptuale të kontabilitetit dhe mënyrën se si kjo e informon procesin e vendosjes së standardeve.

Pjesa më e madhe e planprogramit mbulon raportimin e informacioneve financiare për kompanitë e vetme dhe ato në grup, si dhe shtjellon analizat dhe interpretimet e raporteve financiare informative.

Qëllimi


Zhvillimi i njohurive dhe aftësi në kuptimin dhe përdorimin e standardeve të kontabilitetit dhe kornizes teorike në përgaditjen e pasqyrave financiare të njesisë ekonomike, duke përfshirë grupet dhe mënyrën e analizimit dhe interpretimit të pasqyrave financiare.

Aftësitë kryesore

- Diskutimi dhe aplikimi i kornizes konceptuale për raportim financiar
- Diskutimi i kornizes rregullative për raportim financiar
- Përgaditja dhe paraqitja e pasqyrave financiare që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit
- Llogaritja e kombinimeve biznesore në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit
- Analiza dhe interpretimi i pasqyrave financiare

Temat

Temat kryesore të Modulit Raportimi Financiar që do të trajtohen gjatë ligjërates:



Diagrami.2.: Temat që do të trajtohen në Modulin Raportimi Financiar

Struktura e Ekzaminimit

Provimi mbahet në formë të shkruar dhe përmban pyetje nga të gjitha pjesët e tekstit. Testi do të ketë pyetje të hapura të cilat gjenden në kuadër të këtij teksti. Përgjigjet mund të nxirren nga leximi i tekstit dhe nga ligjëratat e mbajtura. Disa prej pyetjeve mund të kërkojnë përgjigje teorike, kurse pjesa më e madhe e tyre do të jenë pyetje të kombinuara dhe përgjigja jepet në kuadër të alternativave të dhëna në test.

Të lexuarit dhe planifikimi i kohës

Për 3 orët e provimit, janë konsideruar 15 minuta kohë për lexim dhe planifikim.

Kjo kohë shtesë është e lejuar në fillim të cdo provimi tre orësh për të lejuar kandidatët t'i lexojnë pyetjet dhe përgjigjet për të filluar planifikimin e tyre para se të fillojnë të shkruajnë përgjigjet. Kjo kohë duhet të përdoret për të siguruar që të gjitha informatat e kërkuara dhe provimi janë lexuar dhe kuptuar si duhet.

Shtojcë: Syllabusi i Detajuar

Syllabusi i Detajuar

1 KORNIZA KONCEPTUALE E RAPORTIMIT FINANCIAR

- 1.1 Nevojat për kornizë konceptuale
- 1.2 Konceptet thelbësore të përkatësisë dhe paraqitjes së besueshme
- 1.3 Karakteristikat rritëse të krahasueshmërisë, verifikueshmërisë, disponueshmërisë në kohë dhe kuptueshmërisë
- 1.4 Njohja dhe matja
- 1.5 Pikpamja ligjore kundrejt pikpamjes komerciale të kontabilitetit
- 1.6 Modelet aleternative dhe praktikat

2 KORNIZA RREGULLATIVE E RAPORTIMIT FINANCIAR

- 2.1 Arsyet e egzistimit të kornzies rregullative
- 2.2 Procesi i vendosjes së standardeve
- 2.3 Njesitë ekonomike të specializuara, jo fitimprurëse dhe njesitë ekonomike të sektorit publik

3 PASQYRAT FINANCIARE

- 3.1 Pasqyra e rrjedhje së parasë
- 3.2 Pasuritë joqarkulluese të prekshme
- 3.3 Pasuritë e paprekshme

- 3.4 Stoqet
- 3.5 Pasuritë dhe detyrimet financiare
- 3.6 Qiratë
- 3.7 Provizionet, Detyrimet dhe Pasuritë e kushtëzuara
- 3.8 Zhvlerësimi i pasurive
- 3.9 Tatimi
- 3.10 Kërkesa Rregullative në lidhje me pergaditjen e pasqyrave financiare
- 3.11 Raportimi i performances financiare

4 KOMBINIMET BIZNESORE

- 4.1 Buxhetimi dhe kostot standarde
- 4.2 Perzierja e materialeve dhe mosperputhjet e rendimenteve
- 4.3 Shitjet e perziera dhe mosperputhjet sasiore
- 4.4 Mosperputhjet e planifikimit dhe ato operacionale
- 4.5 Aspektet e sjelljes se kosos standarde

5 ANALIZIMI DHE INTERPRETIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

- 5.1 Koncepti dhe parimet e grupit
- 5.2 Koncepti i pasqyrave të konsoliduara financiare
- 5.3 Pergatitja e pasqyrave të konsoliduara financiare duke përfshirë pjesmarrje

Udhëzues Studimi

A KORNIZA KONCEPTUALE E RAPORTIMIT FINANCIAR

1 Nevojat për kornizë konceptuale

- Përshkruani çfarë nënkuptojmë me kornizë konceptuale të kontabilitetit
- Diskutoni nëse korniza konceptuale është e nevojshme dhe çfarë zgjedhje tjetër është e mundshme

2 Konceptet thelbësore të përkatësisë dhe paraqitjes së besueshme

- Diskutoni çfarë është e nënkuptuar me përkatësi dhe paraqitje të besueshme dhe përshkruani cilësitë që i rrisin këto karakteristika
- Diskutoni nëse paraqitja e besueshme do të thotë më shumë se përputhshmëri me standardet ndërkombëtare
- Tregoni rrethanat dhe shpalosjet e kërkuara në rastet kur aplikohet shmangia nga “ e vërtetë dhe e drejtë”

3 Karakteristikat rritëse të krahasueshmërisë, verifikueshmërisë, disponueshmërisë në kohë dhe kuptueshmërisë

- Diskutoni çfarë është e nënkuptuar me kuptueshmëri dhe verifikueshmëri për sa i përket provizionit të informacionit financiar
- Diskutoni rëndësinë e krahasueshmërisë dhe disponueshmërisë në kohë të informacioneve për përdoruesit e pasqyrave financiare
- Bëni dallimin në mes politikave të kontabilitetit dhe ndryshimeve në vlersimet

e kontabilitetit dhe përshkruaj se si standardet e kontabilitetit e përdorin parimin e krahasueshmërisë kur një njesi ekonomike ndryshon politiken e kontabilitetit.

- Njihni dhe regjistroni ndryshimet në politikat e kontabilitetit dhe korigjimet e gabimeve të peridhuave paraprake.

4 Njohja dhe matja

- Definoni cfaë është e menduar me “njohje” në pasqyrat financiare dhe diskuto kriteret e njohjes.
- Përdorni kriteret e njohjes për:
 - Pasuritë dhe detyrimet
 - Të ardhurat dhe shpenzimet
- Diskutoni çështjen e njohjes së të hyrave; Trego kur duket të ndodhë njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve
- Demonstroni rolin e parimit të prevalimit të përmbajtjes mbi formën në lidhje me njohjen e të hyrave nga shitja.
- Shpjegoni masat pasuese dhe llogaritjet duke përdorur:
 - Koston historike
 - Vlerën e drejtë/ koston aktuale
 - Vlerën neto të realizueshme
 - Vlerën e tanishme të rrjedhave të ardhshme të pasasë

5 Pikpamja ligjore kundrejt pikpamjes komerciale të kontabilitetit

- Shpjegoni rëndësinë e regjistrimit të përmbajtjes tragtare në vend të formes ligjore të transaksioneve jep shembuj ku regjistrimi i formes ligjore të transaksionit mund të jetë hutues
- Përshkruani vecoritë të cilat mund të venë në pah që përmbajtja e transaksionit ndryshon nga forma e tij ligjore

- Përdorni parimin e prevalimit të përmbatjes mbi formën në njohjen dhe mosnjohjen e pasurimeve dhe detyrimeve
- Njihni përmbajtjen e transaksionit në përgjithësi dhe në mënyrë të vecantë regjistro llojet e mëposhtme të transaksioneve
 - Mallrat e shitur me zbrije ose mallrate kthyer/stoqet e shtijeve në dorzim
 - Shitja dhe riblerja/marrveshjet e rimarrjes me qira
 - Faktoringu i të arkëtueshmeve

6 Modelet aleternative dhe praktikat

- Përshkruani përparësitë dhe të metat e përdorimit të kontabilitetit të kostos historike
- Diskutoni nëse përdorimi i kontabilitetit të vlerës aktuale i tejkalon problemet e kontabilitetit të kostos historike
- Përshkruani konceptin e ruajtjes së kapitalit financiar dhe kapitalit fizik dhe si ndikon ai në përcaktimin e fitimit

B KORNIZA RREGULLATIVE E RAPORTIMIT FINANCIAR

1 Arsyet e egzistimit të kornzies rregullative

Shpjegoni pse është e nevojshme korniza rregullative duke përfshirë përparësitë dhe të metat e SNRF-së ndaj kornizes rregullative të plotë.

- Shpjegoni pse standardet e kontabilitetit në tërësinë e vet nuk përbajnë një kornizë rregullative të plotë
- Bëni dallimin në mes të kornizes së bazuar në parime dhe kornizës së bazuar në

rregulla dhe shpjego nëse ato mund të jenë plotësuese

2 Procesi i vendosjes së standardeve

- Përshkruani strukturën dhe objektivat e Fondacionit të SNRF-së, Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), Bordit Këshillues të SNRF-së (BK SNRF) dhe Komitetit të Interpretimeve të SNRF (KI SNRF)
- Përshkruaj procesin e vendosjes së standardeve të BSNK-së për sa i përket procesit të vendosjes së standardeve

3 Njesitë ekonomike të specializuara, jo fitimprurëse dhe njesitë ekonomike të sektorit publik

- Bëjë dallimin në mes të qëllimeve parësore të njesive ekonomike jo-fitimprurëse dhe njesive ekonomike të sektorit publik dhe atyre me orientim fitimin
- Diskuto deri në çfarë pike Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar SNRF janë të përshtatshme për njesitë ekonomike të specializuara, jo-fitimprurëse dhe ato të sektorit publik.

4 PASQYRAT FINANCIARE

5 Pasqyra e rrjedhje së parasë

- Përgadit pasqyrën e rrjedhjes së parasë për një njësi ekonomike të vetme (jo për grup) në pajtim me standardet përkatëse të kontabilitetit duke përdorur metoden direkte dhe indirekte
- Krahaso përdorimin e informacionit të rrjedhjes së parasë me atë të të ardhurave ose të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse
- Interpretoni pasqyrën e rrjedhjes së parasë (bashkë me informacionet tjera financiare)

për të vlerësuar performancën e pozitive financiare të njësisë ekonomike

6 Pasuritë joqarkulluese të prekshme

- Definoni dhe llogaritni matjen fillestare të një pasurie jo qarkulluese (duke përfshirë koston e huamarrjes)
- Identifikoni shpenzimet e mëpasshme që mund të kapitalizohen, bëj dallimin në mes të zërave të kapitalit dhe të hyrave
- Diskutoni kërkesat e standardeve përkatëse të kontabilitetit në lidhje me rivlersimin e pasurive joqarkulluese
- Kontabilizoni rivlersimin dhe fitimet apo humbjet nga shitja e pasurive joqarkulluese
- Llogaritni zhvlersimin bazuar në kosto dhe modelet e rivlersimit dhe zhvlersimin e bazuar në pasuri që kanë më shumë se dy pjesë domethënëse (pasuri komplekse)
- Përdorni provizionet e standardeve përkatëse të kontabilitetit në lidhje me kontabilitetin e granteve qeveritare
- Diskutoni pse trajtimi i pasurisë afatgjate materiale të investuar duhet të ndryshoj nga pasuritë afatgjate të tjera
- Përdorni kërkesat e standardeve përkatëse të kontabilitetit për pasuritë afatgjate materiale të investuara

7 Pasuritë e paprekshme

- Diskutoni natyrën dhe trajtimin kontabël të pasurive të krijuara nga brenda dhe atyre të blera
- Bëni dallimin në mes të goodëilli-it dhe pasurive tjera të paprekshme
- Përshkruani kriteret e njohjes fillestare dhe matjen e pasurive të paprekshme
- Përshkruani kriteret e njohjes fillestare dhe matjen e pasurive të paprekshme

- Përshkruani trajtimin vijues kontabël përfshirë parimin e testeve të zhvlersimit në raport me goodëill-in
- Tregoni pse vlera e shumës së blerjeve për një investim mund të jetë më e vogël se vlera e pasurive neto të identifikueshme të përfituara dhe si duhet të regjistrohet dallimi
- Përshkruani dhe aplikoni kërkesat e standardeve përkatëse të kontabilitetit për shpenzimet e kërkimit të zhvillimit

8 Stoqet

- Përshkruani dhe përdorni parimet e vlerësimit të stoqeve
- Definoni kontraten e ndërtimit dhe diskutoni rolin e koncepteve të kontabilitetit në njohjen e fitimit
- Përshkruaj metodat e pranueshme të përcaktimit të fazes së përqindjes së përmbushjes së kontrates
- Përgaditni ekstraktet e pasqyrave financiare për kontratat e ndërtimit

9 Pasuritë dhe detyrimet financiare

- Shpjego nevojën për standarde të kontabilitetit mbi instrumentet financiare
- Definoni instrumentet financiare në aspektin e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare
- Për kategorinë e instrumenteve financiare vijuese tregoni si duhet të maten ato dhe si duhet të trajtohen në pasqyrat financiare humbja ose fitimi nga matjet pasuese
 - Kosto e amostizuar
 - Vlerës së drejtë (përfshirë mundësinë për të përzgjedhur për të paraqitur fitimet dhe humbjet në

- instrumentet e ekuitetit në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse)
- Bëni dallimin në mes të kapitalit borxh dhe kapitalit ekuitet
- Përdorni kërkesat e standardeve përkatëse të kontabilitetit për emetimin dhe kostot financiare të:
 - Ekuitetit
 - Aksioneve preferenciale të riblershme dhe instrumentet e borxhit pa të drejtë konvertimi (parimi i ksostot së amortizuar)
 - Borxhi i konvertueshëm

10 Qiratë

- Shpjegoni pse regjistrimi i formes ligjore të qirasë financiare mund të jetë ç'orientues për perdoruesit (duke i'u referuar përmbajtjes tregtare të qirave të tilla)
- Përshkruani dhe aplikoni metoden e përcatimit të tipit të qirasë (qira e zakonshme ose qira financiare)
- Diskutoni efektin e trajtimit gabimisht të një qiraje financiare si qira e zakonshme në pasqyrat financiare
- Llogaritni pasuritë e financiare nga qiratë financiare në regjistrimet e qiramarrësit
- Llogaritni qiratë e zakonshme në regjistrimet e qiramarrësit

11 Provizionit detyrimet dhe pasuritë e kushtëzuara

- Shpjegoni kur është i nevojshëm standardi i kontabilitetit mbi provizioni
- Bëni dallimin në mes të detyrimeve ligjore dhe konstruktive
- Konstatoni kur mund/nuk mund të bëhen provizionet dhe demonstroi se si ato duhet të kontabilizohen
- Shpjegoni se si duhet të maten provizionet

- Definoni pasuritë dhe detyrimet e kushtëzuara dhe përshkruani trajtimin e tyre kontabël
- Identifikoni dhe kontabilizoni
 - Garancionet
 - Kontratat me kushte renduese:
 - Provizionet medimore dhe të ngjashme
 - Provizionet për riparimet e ardhëshme ose renovimet

12 Zhvlerësimi i pasurive

- Definoni një humbje zhvlerësimi
- Identifikoni rrethanat që mund të tregojnë zhvlerësimin e pasurive
- Përshkruani cfarë është menduar me njësi gjeneruese të parave
- Konstatoni bazat mbi të cilat humbja zhvlerësuese duhet të shpërndahet dhe shpërndani humbjen nga zhvlerësimi tek pasuritë e njëjse gjeneruese të parave

13 Tatimi

- Kontabilizoni tatimin aktual në pajtim me standardet përkatëse të kontabilitetit
- Regjistroni hyerjet që i përkasin tatimit mbi të ardhurat në regjistrimet e kontabilitetit
- Shpjegoni efektin e diferencave të përkohshme të tatueshme dhe fitimeve të tatueshme
- Llogaritni dhe regjistroni shumat e tatimeve të shtyra në pasqyrat financiare

14 Kërkesat rregullative lidhur me përgaditjen e pasqyrave financiare

- Përshkruani strukturën (formatin) dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të paraqitura sipas SNRF

- Përgaditni pasqyrat financiare të një njësie ekonomike në pajtim me strukturën dhe përmbajtjen e parashikuar

15 Raportimi i performances financiare

- Diskutoni rëndësinë e identifikimit dhe raportimit të rezultateve të veprimtarive të ndërprera
- Definoni dhe kontabilizoni pasurtië joqarkulluese të mbajtura për tu shitur dhe veprimtaritë e ndërprera
- Tregoni rrethanet kur kërkohet një shpalesje e ndarë e zërave materiale të të ardhurave dhe shpenzimeve
- Përgaditni dhe shpjegoni përmbajtjen dhe qëllimin e pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet
- Përshkruani dhe përgaditni pasqyrën e ndryshimit në ekuitet

C KOMBINIMET BIZNESORE

1 Koncepti dhe parimet e një grupi

- Përshkruani konceptin e grupit si njësi e vetme ekonomike
- Shpjegoni dhe përdorni definicionin e filialeve branda standardeve përkatëse të kontabilitetit
- Duke përdorur standardet e kontabilitetit dhe rregulloret tjera të aplikueshme, identifikoni dhe ilustroni rrethanat në të cilat nga grupi kërkohet të përgatitë pasqyrat e konsoliduara financiare
- Përshkruani rrethanat kur grupi mund të kërkojë përjashtim në përgaditjen e pasqyrave të konsoliduara financiare
- Shpjegoni pse drejtuesit mund të mos duan të konsolidojnë një filiale dhe ilustroni rrethanat kur një gjë e tillë është e lejuar,

duke përdorur standardet e kontabilitetit dhe rregulloret tjera të zbatueshme

- Shpjegoni nevojën e përdorimit të datave të njëjta të përfundimit të periudhave kontabël dhe politikave të njëjta të kontabilitetit gjatë përgaditjes së pasqyrave financiare
- Shpjegoni pse është e nevojshme të menjaherë transaksionet brenda grupit

2 Koncepti i pasqyrave financiare të konsoliduara

- Shpjegoni qëllimin e pasqyrave të konsoliduara financiare
- Tregoni efektin që mund të ketë marrëdhënia e palëve të lidhura mes kompanisë mëmë dhe filialeve të saj në pasqyrat e filialeve dhe pasqyrat e konsoliduara financiare
- Shpjegoni pse është e nevojshme të përdoret vlera e drejtë për shumën e investimit në filiale bashkë me vlerën e drejtë të pasurive dhe detyrimeve të identifikueshme të filialeve gjatë përgaditjes së pasqyrave të konsoliduara financiare
- Përshkruani dhe përdor trajtimin e kërkuar kontabël të good-ëillit të konsoliduar

3 Përgaditni pasqyrat e konsoliduara financiare duke përfshirë pjesëmarrjen

- Përgaditni pasqyrën e konsoliduar të bilancit të gjendjes për një grup të thjeshtë (kompani mëmë dhe një filiale) duke përfshirë fitimet para dhe pas blerjes, interesin jo kontrollues dhe goodëill-in e konsoliduar
- Përgaditni një pasqyrë të konsoliduar të të ardhurave dhe një pasqyrë të konsoliduar të të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për një

grup të thjeshtë duke përfshirë blerje gjatë periudhes dhe interesin jo-kontrollues.

- Shpjegoni dhe kontabilizoni rezervat tjera (p.sh: Primin e lidhur me aksion dhe rezervat e rivlerësimit)
- Kontabilizo efektet e tregimit benda grupit në pasqyrat financiare
- Kontabilizoni efektet e rregullimeve të vlerës së drejtë (përfshirë efektet e tyre në goodëill-in e konsoliduar) në:
 - i) Zhvlerësimin dhe jozhvlerësimin e pasurive joqarkulluese
 - ii) Stoqet
 - iii) Detyrimet monetare
 - iv) Pasurti dhe detyrimet e papërfshira në pasqyrën e bilancit të gjendjes të vetë filiales, përfshirë pasuritë dhe detyrimet e kushtëzuara.
- Kontabilizoni zhvlerësimin e goodëill-it
- Definoni një pjesmarrës dhe shpjego parimet dhe arsyet e përdorimit të kontabilitetit të ekuitetit
- Përgaditni pasqyrat e konsoliduara financiare duke përfshirë një filiale dhe një pjesmarrje

4 Kalkulimi dhe interpretimi i raporteve kontabël dhe trendet e adresimit të nevojave të përdoruesve dhe palëve të interesuara

- Definoni dhe llogarisni raportet kontabel më kryesore
- Shpjegoni cilat aspekte të raporteve specifike të performances synohet të vlerësohen
- Analizoni dhe interpretoni që të jepni një vlerësim të performancës së njësisë

- Diskutoni se si pasqyrat financiare mund të keqpërdoren për të japë efektin e dëshiruar (kontabilitetit kreativ, rregullimi i paraqitjes)
- Tregoni se si marrëdhënia mes palëve të lidhura mund të sjellë ngatërrimin e përdoruesve
- Shpjegoni pse shifrat në pasqyrën e bilancit të gjendjes mund të mos jenë përfaqësuese të vlerave monetare përgjatë periudhës për shmebull, për shkak të:
 - i) Tregtisë sezonale
 - ii) Blerjeve të mësha të pasurive në fund të përidhuës kontabël ekonomike

5 Kufizimet e teknikave të interpretimit

- Diskutoni kufizimet në përdorimin e analizave dhe raporteve për vlerësimin e performances së shoqerive tregtare
- Diskutoni efektet që ndryshimet në politikat e kontabilitetit ose në përdorimin e politikave të ndryshme të kontabilitetit mes njësisë ekonomike mund të kenë në aftësitë për të interpretuar performances
- Tregoni informacionet tjera, përfshirë informacionet jofinanciare, që mund të jenë me rëndësi në vlerësimin e performancës së njësisë ekonomike

6 Njesitë ekonomike të specializuara, jo fitimprurëse dhe njesitë ekonomike të sektorit publik

- Diskutoni metodat e ndryshme që mund të kërkohen kur vlerësohen organizatat e specializuara, jo fitimprurëse dhe ato të sektorit publik.